

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

1. OBJEKTI I PROCEDURËS:

ARREDIM ZYRASH

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39150000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,490,866.40 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë, presje dyzet) lekë pa tvsh.

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, bazuar ne MESATAREN E 3 OFERTAVE TE TREGUT grupi I punës ka bërë përlllogaritjen e vlerës limit te kontrates.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Në zbatim të nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedure e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesi bilancin vjetor, për vitin financiar 2025.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin e kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vetem 1 viti të kërkuar për paraqitjen e bilancit 2025 është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit (duke përfshirë edhe kështet e maturuara për vitin 2026, duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore), për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kështeteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti Teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

- 2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. (Nëse katalogu/ broshura/skeda teknike paraqitet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën shqipe).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve /broshurës/ skedës teknike është një kërkesë proporcionale dhe ngushtësisht e lidhur me objektin e prokurimit pasi i jep mundësinë AK për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.


- 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** dhe montimin e artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar PREJ TIJ.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KATALOG MOBILIERI ZYRE PAMJE DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

01 TAVOLINË NË FORMË L ME SIRTAR PAMJE IZOMETRIKE




DIMCIFIKIMET TEKNIKE

- Përmasa: 2500 x 1500 x 750 mm
- Materiale: Melaminë 25 mm (MDF/Cipboard)
- Anët dhe paneli ballor: 18 mm
- Buzë: ABS 2 mm
- Kasetierë me 3 sirtarë me bravë
- Shina teleskopike metalike
- Doreza alumini
- Nivëlues plastikë në këmbë
- Ngjyra: Sonoma Oak (ose e ngjashme)
- Rezistente ndaj lagështirës dhe gërvishjeve

NGJYRA TË DISPONUESHME



02 TAVOLINË E DREJTË ME SIRTAR PAMJE IZOMETRIKE



SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Përmasa: 2000 x 700 x 750 mm
- Materiale: Melaminë 25 mm (MDF/Cipboard)
- Anët dhe paneli ballor: 18 mm
- Buzë: ABS 2 mm
- Kasetierë me 3 sirtarë me bravë
- Shina teleskopike metalike
- Doreza alumini
- Nivëlues plastikë në këmbë
- Ngjyra: Sonoma Oak (ose e ngjashme)
- Rezistente ndaj konsumimit dhe gërvishjeve

NGJYRA TË DISPONUESHME



03 KARRIGE ZYRE ME RROTULLIM PAMJE IZOMETRIKE



SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Karrige rrotulluese 360°
- Mbështetëse rrjete (mesh) ergonomike
- Mekanizëm: Tilt me bllokim
- Iregullim lartësie me piston hidraulik
- Mbështetëse krahu (me lartësi fikse)
- Bazë poliamid me 5 rrota
- Kapacitet mbajtës: deri në 120 kg
- Ngjyrë: E zezë

MATERIALE



04 DOLLAP ZYRE PËR DOKUMENTACION PAMJE IZOMETRIKE



SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Përmasa: 1800 x 1800 x 400 mm
- Materiale: Melaminë 18 mm (MDF/Cipboard)
- Buzë: ABS 2 mm
- 5 rafta të rregullueshme
- Dyer me mentesha metalike me bravë
- Doreza alumini
- Ngjyra: Sonoma Oak (ose e ngjashme)
- Rezistente ndaj lagështirës dhe konsumimit

NGJYRA TË DISPONUESHME



CILËSIA DHE GARANCIA

Të gjitha produktet janë prodhuar me materiale cilësore dhe me standarde të larta. Garanci 24 muaj për defekte prodhimi.



AFATI I FURNIZIMIT

Brenda 7 - 15 ditëve nga data e konfirmimit të porosisë.



MONTAZHI

Montazhi përfshihet në çmim dhe kryhet nga ekipi ynë i specializuar.



NGJYRA DHE FINITURA

Ngjyrat dhe teksturat mund të personalizohen sipas kërkesës së klientit dhe ambientit të zyrës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE KATALOG MOBILIERI ZYRE



MATERIALE
CILËSORE



PRODUKTE
ERGONOMIKE



GARANCI
24 MUAJ

SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

Të gjitha produktet e përfshira në këtë katalog janë prodhuar me materiale cilësore dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet teknike dhe funksionale të arredimit të ambienteve të punës. Mobiliat janë projektuar për të ofruar qëndrueshmëri, rehati dhe ergonomi, duke garantuar përdorim afatgjatë dhe mirëmbajtje të lehtë.

- Materiale cilësore:** Përdorim i materialeve të certifikuara, rezistente ndaj konsumit dhe gërvishjeve.
- Dizajn funksional:** Produkte të dizajnuara për të maksimizuar hapësirën dhe për të krijuar ambiente pune komode.
- Ergonomi e garantuar:** Tavolina dhe karrige të projektuara për të siguruar pozicion të drejtë të trupit dhe lehtësi në përdorim.
- Montim profesional:** Montimi kryhet nga ekip i specializuar për çdo artikull.
- Përputhshmëri estetike:** Ngjyra dhe dizajn të koordinuara për një ambient pune modern dhe profesional.
- Mirëmbajtje e lehtë:** Sipërfaqe të lehta për pastrim dhe materiale që ruajnë cilësinë në kohë.
- Standard sigurie:** Mobiliat janë të sigurta për përdorim dhe në përputhje me standardet e sigurisë në punë.



CILËSIA DHE GARANCIA

Të gjitha produktet janë prodhuar me materiale cilësore dhe me standarde të larta. Garanci 24 muaj për defekte prodhimi.



AFATI I FURNIZIMIT

Brenda 7 - 15 ditëve nga data e konfirmimit të porosisë. Afati mund të ndryshojë në varësi të sasisë së porositur dhe kushteve të furnizimit.



MONTAZHI

Montazhi përfshihet në çmim dhe kryhet nga ekipi i specializuar. Çdo produkt dorëzohet i montuar dhe gati për përdorim.



NGJYRA DHE FINITURA

Ngjyrat dhe teksturat mund të personalizohen sipas kërkesës së klientit dhe ambientit të zyrës. Disponohen nuanca druri dhe ngjyra neutrale.



PËRMIRËSIM I VAZHUESHËM

Prodhuësit tanë punojnë vazhdimisht për përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe për përditësimin e koleksioneve sipas nevojave të klientëve dhe tendencave moderne të arredimit.

Kërkesa të përgjithshme:

1. Të gjitha mobiliat duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe prodhim i ri.
2. Materialet duhet të jenë rezistente ndaj konsumimit, lagështirës dhe gërvishtjeve gjatë përdorimit normal administrativ.
3. Të gjitha elementet metalike duhet të jenë të mbrojtura ndaj korrozionit.
4. Furnizimi përfshin transportin, shkarkimin, montimin dhe vendosjen në ambientet e Autoritetit Kontraktor.
5. Produktet duhet të dorëzohen të montuara dhe funksionale.
6. Operatori ekonomik duhet të garantojë zëvendësimin e çdo elementi me defekt gjatë periudhës së garancisë.
7. Toleranca e përmasave lejohet deri në $\pm 5\%$, pa cenuar funksionalitetin dhe cilësinë e produktit.
8. Mobiliat duhet të jenë ergonomike, të përshtatshme për përdorim administrativ dhe të harmonizuara në dizajn dhe ngjyrë.

Argumentimi I specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike të hartuara janë përcaktuar mbi bazën e nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Kërkesat teknike janë vendosur për të garantuar furnizimin me mobilie cilësore, ergonomike, funksionale dhe me jetëgjatësi të lartë, të përshtatshme për përdorim të vazhdueshëm administrativ.

Kërkesa që mobiliat të jenë të reja, të papërdorura dhe prodhim i ri është vendosur për të garantuar cilësinë, jetëgjatësinë dhe përfitimin e plotë të garancisë së produktit.

Përdorimi i materialeve rezistente ndaj konsumimit, lagështisë dhe gërvishtjeve argumentohet nga përdorimi intensiv i mobilieve në ambientet administrative, ku kërkohet ruajtja e parametrave funksionalë dhe estetikë për një periudhë të gjatë.

Mbrojtja e elementeve metalike nga korrozioni është e domosdoshme për të siguruar qëndrueshmërinë mekanike dhe jetëgjatësinë e mobilieve.

Përfshirja e transportit, shkarkimit, montimit dhe vendosjes është kërkuar për të garantuar dorëzimin e produkteve plotësisht funksionale, duke shmangur kosto shtesë për autoritetin kontraktor.

Dorëzimi i mobilieve të montuara dhe funksionale siguron që produktet të jenë menjëherë të përdorshme dhe të verifikueshme nga komisioni i marrjes në dorëzim.

Garancia për zëvendësimin e elementeve me defekt gjatë periudhës së garancisë është kërkuar për të mbrojtur interesin ekonomik të autoritetit kontraktor dhe për të garantuar cilësinë e furnizimit. Toleranca dimensionale deri në $\pm 5\%$, pa cenuar funksionalitetin dhe cilësinë, është vendosur për të lejuar ndryshime të vogla prodhimi ndërmjet prodhuesve, duke mos kufizuar konkurrencën.

Kërkesa që mobiliat të jenë ergonomike dhe të harmonizuara në dizajn dhe ngjyrë argumentohet nga nevoja për krijimin e ambienteve të përshtatshme të punës, rritjen e komoditetit të punonjësve dhe unifikimin estetik të zyrave.

Specifikimet teknike janë përcaktuar mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor dhe standardeve të zakonshme të tregut.

Këto kërkesa nuk referojnë marka, prodhues apo origjinë të caktuar dhe lejojnë ofertimin e çdo produkti ekuivalent që plotëson parametrat teknikë të kërkuar.

Keto Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

NJËSIA E PROKURIMIT